

VENDIM
Nr.1345, datë 10.10.2008

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE TË DY NGA STRAVE TË
EKONOMISË PYJORE “DHËMBEL-KALA”, PËRMET”, QË DO TË PËRDOREN NGA
“CFF” SHPK, PËR PRODHIM PLLAKASH GURI DEKORATIV**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet e ngastrave 98/a e 99/a, të ekonomisë pyjore “Dhëmbel-Kala”, Përmet”, që do të përdoren nga “CFF” sh.p.k., për prodhim guri dekorativ, në një sipërfaqe, gjithsej, 5 ha, të hiqen nga fondi pyjor kombëtar dhe të çregjistrohen nga zëri kadastral “Pyll”, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin në terren dhe në hartë të kufijve të rinj të fondit pyjor kombëtar, pas heqjes së sipërfaqeve të ngastrave, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfundimin e procedurave për pagesat, në përputhje me vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

3. “CFF” sh.p.k., brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të pyllëzojë, me shpenzimet e veta, 5 ha me pyje, sipas ngastrave të përcaktuara nga drejtoria e shërbimit pyjor.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




TABELA NR.1
NGASTRA QË KËRKOHEN PËR HEQJE NGA FONDI PYJOR

Nr.	Ekonomia pyjore	Ngastra, n/ngastra	Kërkuar ha	Zëri kadastral	Forma e qeverimit	Funksioni	Pronësia	Objekti
1	EP Dhëmbel-Kala	98/a	4.625	Pyll	Shkurre	Prodhues	Publike	Karrier guri
2	EP Dhëmbel-Kala	99/a	0.375	Pyll	shkurre	prodhues	publike	Karrier guri
			5.00					

